

**URDHËR**  
**Nr.319, datë 4.8.2011**

**PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT, PËR MIRATIMIN E PAGESAVE TË SHITESËS  
PËR ORË PUNE MBI KOHËN NORMALE TË PUNËS, PËR PUNONJËSIT E POLICISË  
SË SHITETIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 27-33 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, të pikës 2/c të nenit 7 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe të vendimit nr.463, datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore””, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të autoritetit për miratimin e pagesave të shtesës për orë pune mbi kohën normale të punës, për punonjësit e Policisë së Shtetit.
  2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BRENDSSHËM**  
**Bujar Nishani**